

VENDIM
Nr.567, datë 3.8.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2004, 2008, 2010, PËR
PROJEKTIN “HEQJA E MBETURINAVE NË SHQIPËRINË JUGLINDORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004, 2008, 2010, për projektin “Heqja e mbeturinave në Shqipërinë Juglindore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2004, 2008, 2010 PËR PROJEKTIN “HEQJA E MBETURINAVE NË
SHQIPËRINË JUGLINDORE”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës federale të Gjermanisë

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë.

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshje.

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

duke ju referuar notës verbale 471/04 të datës 21 dhjetor 2004 dhe protokolleve të bisedimeve ndërqeveritare të datës 7 tetor 2008 dhe të datës 18 maj 2010.

ranë dakord si vijon:

Neni 1

1) Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumat e mëposhtme për projektin “Heqja e mbeturinave në Shqipërinë Juglindore”:

1. Një hua me vlefë prej gjithsej deri në 3 400 000 euro (me fjalë tre milionë e katërqind mijë euro) nga premtimi i vitit 2004, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur.

2. Një shumë financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen

e projektit me vleftë prej gjithsej deri në 1 000 000 euro (me fjalë një milionë euro) nga premtimi i vitit 2010.

3. Disa shuma financimi me vleftë prej gjithsej 7 400 000 euro (me fjalë shtatë milionë e katërqind mijë euro) për projektin, me

a) deri në 3 000 000 euro (me fjalë tre milionë euro) nga premtimi i vitit 2008;

b) deri në 4 400 000 euro (me fjalë katër milionë e katërqind mijë euro) nga premtimi i vitit 2010.

Kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.

2) Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3) Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

4) Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 pikë 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, pikë 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2012. Për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1 pika 3a, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2016. Për shumat e përmendura në nenin 1, paragraf 1 pikat 2 dhe 3b, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë

detare, tokësore dhe ajrore që rezultojn nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brenda shtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 19 korrik 2011 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

VENDIM

Nr.568, datë 3.8.2011

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË E MESME E PËRGJITHSHME “GJIMNAZI FRANKO-SHQIPTAR “ERNEST KOLIQI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme “Gjimnazi franko-shqiptar “Ernest Koliqi”, që do të përfshijë në programin mësimor edhe lëndë në gjuhë të huaj.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha